



ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: KUVENDI KOMUNAL NOVO BRDO

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP:

Nr. i Prokurimit ¹	654-20-5059-2-3-6
Nr i brendshëm	Nb 654 2020 020 236

Titulli: "Shërbimet e Dezinfektimit të brendshëm në Komunën e Novobërdës"

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

AHMET R.RRUSTEMI B.I – Insects DDD

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Xhemail Mustafa III/42,

(Adresa)

Gjilan

(Vendi)

044212581

(Numri Telefonit)

60000

(Kodi postar)

(Numri i Faks-it)

Ahmet Rrustemi

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

ahmetrrustemi69@gmail.com

(Adresa elektronike)

19.11.2020

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

Insects D.D.D.
Ahmet Rrustemi B.I.
Gjilan - Kosovë

*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.

2. Identifikimi i avokatit

¹ Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs të projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës].

- Njoftimi per kontrate dt.08.09.2020
- Afati i fundit per dorezim te tenderit dhe hapje te tenderit 14.09.2020
- Njoftimi per vendimin per dhenje te kontrates 26.10.2020
- Tenderi i pergjegjshem me Çmim me te ulet
- Njoftimi për dhënie të kontratës dhe letrën standarde për tenderuesit e pa sukseshëm me dt.26.10.2020
- Kërkesa për ri-shqyrtim me dt.28.10.2020,
- Pergjigje per kërkesën për ri-shqyrtim me dt.03.11.2020
- Njoftimi per vendimin 17.11.2020

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒

Jo ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒

Jo ☐

Kundër vendimit për dhënje të kontratës dhe letrës stanfarde për OE të pa sukseshëm kemi parshtruar kërkesë për ri-shqyrtim tek AK-Komuna e Novoberdës me dt.28.10.2020. AK- Komuna e Novoberdës me dt.03.11.2020 na njofton se është aprovuar kërkesa për rishqyrtim, ndersa me datën 17.11.2020 pranojmë Njoftimin mbi vendimin e AK ne të cilin shperblyer me kontrate MONUNI SHPK – i njeiti OE i cili ishte shperblyer me kontrate edhe me vendimin e dates 26.10.2020 por me emer te ndryshem pasiqe kishte ndryshuar emrin. Ndersa pretendimin tone qe kishim derguar ne kerkesen per rishqyrtim nuk na jane pergjigjur fare. Pasiqe ne si OE i passuksesshem pas qasjes ne dokumentacionin e FAUNA GROUP SHPK (MONUNI SHPK) OE te rekomanduar per kontrate kemi verifikuar qe i njeiti eshte i papergjegjshem i cili nuk i ka plotesuar kerkesat e kerkuara me DT.

Bazuar në dispozitat e nenit 109 të LPP parashtroj ankesë kundër Vendimit për dhenje te kontrates si dhe Letrës standarde si OE i pasukseshëm.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Me rastin e refuzimit të kërkesës për ri-shqyrtim AK ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e LPP-së dhe atë të:

- Neni 1,
- Neni 7,
- Neni 28 Specifikimet teknike i LPP
- Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve
- Neni 69
- Neni 72
- Neni 108/A të LPP-ës

**** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.**

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

AK me rastin e ri-shqyrtimit të kërkesës sone nuk ka vepruar konform nenit 108A të LPP me qëllim të evitimit të gabimeve me rastin e vlersimit, ekzminimit dhe krahasimit të ofertave, për qudi i njejt i ka konfirmuar shkeljet të cilat janë bërë në fazën e vlerësimit dhe fare nuk ka dhënë përgjigje në pretendimet tona ankimore se qëndrojnë apo nuk qëndrojnë. Ne nuk pajtohemi me vendimin e AK-Komuna e Novobërdës pasiqe OE MONUNI SHPK është i pa përgjegjshëm dhe se i njejt nuk ka plotësuar kërkesat e DT me qka AK-Komuna e Novobërdës me rastin e ri-shqyrtimit të aktivitetit të prokurimit: "Shërbimet e Dezinfektimit të brendshëm në Komunën e Novobërdës" me nr i prokurimit 654-20-5059-2-3-6" ka bërë konstatim te gabuar te gjendjes faktike dhe shkelje te dispozitave te LPP-se:

I paknaqur me Letren standarde per tenderuesin e pasuksesshem si dhe Njoftimin mbi Vendimin e AK per shperblim me kontrate MONUNI SHPK, Gjilan me daten 17.11.2020 ne lidhje me projektin Shërbimet e Dezinfektimit të brendshëm në Komunën e Novobërdës ne afatin e lejuar ushtroje këtë:

ANKESË

Pas pranimit te Letres standarde per eliminim edhe Njoftimin per Vendim-Shperblim me kontrate kemi kerkuar nga AK çasje ne dokumentacionin e OE te rekomanduar per kontrate pasi kemi pasur dyshimet tona qe i njejt është i papergjegjshem i cili nuk i ka plotësuar kërkesat e kerkuara me DT.

Me daten 28.10.2020 ne kemi pranuar dokumentacionin e OE te rekomanduar per kontrat dhe gjate kontrollimit te dokumentacionit te OE ne kemi verejte se OE i mungojne paisjet e kerkuara ne dosjen e tenderit.

Ne parashtruam kerkesen per rishqyrtim por AK serish mori te njetin Vendim dhe shperbleu me kontrate te njetin MONUNI SHPK (FAUNA GROUP SHPK emri i vjeter)

Andaj ne si OE te pakenaqur me vendimin e tyre njoftojme panelin shqyrtues dhe ekspertin shqyrtues si më poshtë:

Ne baze te Dosjes se tenderit faqe 5 , te Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, është kerkuar Paisjet e nevojshme minimum nje ULV-ELEKTROSTATIKE , ndersa si deshmi është kerkuar Fatura dhe DUD-i apo marreveshjen me qira, po ashtu sipas Sqarimeve te dhena me daten 10.09.2020 është kerkuar e njeta dhe është sqaruar se nese ofrohet marreveshja me qira edhe qiradhenesi duhet te deshmoje pronesine e paisjeve.

OE i rekomanduar per kontrate nga ana AK nuk posedon kete pajisje (ULV-

ELEKTROSTATIKE).

Ne baze te kontrollimit te dokumenteve ne kemi pa qe ka ofruar paisje tjera por jo ULV-ELEKTROSTATIKE qe kerkohet ne Dosje te tenderit

Lista e pajisjeve e bashkangjitur me oferte ka 8 lloje te pajisjeve ku me numer 6 eshte e renditur pajisja qe eshte kerkuar ne dosje te tenderit. 6.Hurricane ULTRA ULV (Elektrostatike). POR, per kete pajisje nuk ka ofruar as fature, as DUD-in, e as marreveshje per shfrytezim me qira. Po ashtu per kete pajise ka shenuar te sasia qe i posedon 2 cope dhe prodhuesi USA. Nese e kontrolloni edhe njeher ne detaje fajllin Lista e Pajisjve prej 18 faqe do te vertetoni se per kete pajisje nuk ka asnje deshmi te posedimit te saj.

Ne po ju shenojme per secilen deshmi se qka ka ofru tek fajlli Lista e pajisjve te DDD-se dhe deshmitë mbi pronesine:

Faqe 1. Lista e pajisjeve

Faqe 2. DUD-i per Igeba U15HDM

Faqe 3. DUD-i per Igeba TF35

Faqe 4 dhe 5. Fatua per Igeba U15HDM dhe Igeba TF35

Faqe 6. Fature per Motor 450

Faqe 7. Certifikata per Igeba

Faqe 8 dhe 9. Manuali per pajisje Port 423

Faqe 10. Fatura per Igeba U15HDM

Faqe 11. Fatura per Sperkatese motorike nga Agromarket

Faqe 12 dhe 13. DUD-i per sperkatese shpine per perdorim ne bujqesi 16 litersh

Faqe 14. Fatura per pompat qe perdoren ne bujqesi

Faqe 15-18. Foto gjate sherbimeve DD.

Te gjitha keto pajisje te listuara ne listen me larte nuk jane kerkuar sipas dosjes se tenderit. Dhe sipas ketyre dokumenteve qe ka ofru si deshmi ne nuk pame asnje deshmi per Paisjen e kerkuar ne DT- minimum nje ULV-ELEKTROSTATIKE , ndersa si deshmi eshte kerkuar Fatura dhe DUD-i apo marreveshjen me qira.

Prandaj ne te gjeturat e lartepermendura me larte eshte e qarte se OE i rekomanduar per kontrate eshte i papergjegjshem ne kete procedure te prokurimit dhe si te tille komisioni i vleresimit eshte dashte ta eliminon e jo ta shperblehen me kontrate si dhe me rastin e rishqytimit e kane bërë të njejtën.

Nga të cekurat më lartë të cilat janë evidente kërkojmë nga Paneli shqyrtues me rastin shqyrtimit të ankesës kërkesës tonë lidhur me tenderin "Shërbimet e Dezinfektimit të brendshëm në Komunën e Novobërdës" me nr i prokurimit 654-20-5059-2-3-6" të merr këtë:

V E N D I M

1.Aprovohet si e bazuar ankesa e "Ahmet R.Rrustemi B.I – "Insects DDD" lidhur me tenderin "Shërbimet e Dezinfektimit të brendshëm në Komunën e Novobërdës" me nr i prokurimit 654-20-5059-2-3-6"

2.Anulohet njoftimi për dhënie të kontratës lidhur me tenderin : "Shërbimet e Dezinfektimit të brendshëm në Komunën e Novobërdës" me nr i prokurimit 654-20-5059-2-3-6 dhe lënda kthehet në ri-vlerësim.

Shpresojmë që ju si Panel shqyrtues do te merrni një vendim të drejtë dhe të mos lejoni që Komuna e Novoberdes qe te mos vepron në kundërshtim me dispozitat e LPP-së.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkëngjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,*
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe*
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*